

HULUMTIMI I PARAMETRAVE AGROBIOLOGJIK TË DISA KULTIVARË TË QERSHISË (SABRINA, KRISTINA, FOLFER *Prunus avium*)

ABSTRAKTI

Qershia është një bimë drunore e familjes Rosacea dhe përzgjedhja e kultivarëve është mjaftë me rëndësi për kultivimin e qershive dhe arritjen e rendimenteve sa me të larta. Ky studim ka për qëllim të vë në pah ndikimin e disa faktorëve në kushtet agrometeorologjike të Kosovës dhe përshtatjen e tre kultivarëve Sabrina, Kristina dhe Folfer. Studimi është kryer në vitin 2022, janë përcjellë të gjitha fenofazat e zhvillimit të bimëve nga fillimi I vegjetacionit deri në vjelje. Që nga fillimi i vegjetacionit në çdo fenofazë janë bërë matje dhe krahasime në mes tre kultivarëve, po ashtu janë marrë mostrat e frutave dhe janë bërë analizat e frutave në institutin e Pejës. Rëndësia e hulumtimit qëndron në faktin se përmes tij arrijmë të dimë cili nga kultivarët ka përshtatshmëri më të madhe të kultivimit në vendin tonë, cili nga kultivarët jep rendimente më të larta, cili nga ta ka bujshmëri më të madhe cili nga ta fillon lulëzimin me herët, cili nga ta është më rezistentë nga plasaritja e frutave, cili nga ta ka madhësi më të madhe të frytit, etj. Përmes këtij hulumtimi është arritur në përfundim se të tre kultivarët kanë periudhë afërsisht të ngjashme të fillimit të periudhës së pjekjes. Kultivari Kristina ka fruta më të vegjël por jep rendimente më të larta në raport me dy kultivarët tjerë Sabrina dhe Folfer. Kultivari Folfer ka fruta më të mëdhenj në krahasim me dy kultivarët tjerë. Të tre kultivarët janë të ndjeshëm nga plasaritja e frutave.

Fjalët kyçe : Qershia, kultivarët, Sabrina, Kristina, Folfer, parametrat agrobiologjik

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Bekë Pepshi